

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 26 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUHDHËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokoll 8648/24; dhe nenit 5, nenit 6, paragrafi 4, nenit 7 dhe nenit 8 të RREGULLORES PËR PROCEDURËN E LICENCIMIT, RILICENCIMIT, MIRËMBAJTJEN, PEZULLIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCËS SË INXHINIERIT TË LICENCUAR TË ODËS, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 06.05.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

- Të hapet aplikimi për licencim të inxhinierëve në fushën e ndërtimit**, duke filluar nga data **12.05.2025**, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Procedurën e Licencimit, Rilicencimit, Mirëmbajtjen, Pezullimin dhe Revokimin e Licencës së Inxhinierit të Licencuar të Odës.
- Aplikimi bëhet në formë fizike**, duke dorëzuar dokumentacionin përkatës në arkivin e OIRK-së, në adresën: **Kompleksi Rilindja, Kontejneri Nr. 3, kati i 2-të, 10000 Prishtinë**.
- Këto dokumente, së bashku me njoftimin për aplikim**, përbëjnë paketën e aplikimit dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi si **shtojca zyrtare**:
 - Shtojca 1: Njoftimi për aplikim
 - Shtojca 2: Formulari për aplikim për licencim
 - Shtojca 3: Dëshmia e përvojës së punës në profesion
 - Shtojca 4: Deklarata e përgjegjësisë profesionale
- Zbatimin e këtij vendimi e bën Komisioni Vlerësues**, i themeluar nga Bordi Drejtues, në përputhje me Rregulloren në fuqi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

- Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së _____
- Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
- Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
- Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
- Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
- Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
- Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OIRK)

NJOFTIM PËR APLIKIMIN PËR LICENCË PËR INXHINIERËT NË FUSHËN E NDËRTIMIT

Në mbështetje të: nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, dhe nenit 26 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 8 dhe nenit 27, të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokollit 8648/24; dhe nenit 5, nenit 6, paragrafi 4, nenit 7 dhe nenit 8 të RREGULLORES PËR PROCEDURËN E LICENCIMIT, RILICENCIMIT, MIRËMBAJTJEN, PEZULLIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCËS SË INXHINIERIT TË LICENCUAR TË ODËS, njoftojmë të gjithë inxhinierët se duke filluar nga data **12.05.2025** mund të aplikojnë për licencim në OIRK.

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

- Formulari për aplikim – Shtojca 1.
- Kopje e letërnjoftimit ose pasaportës.
- Fotografi (35x45 mm).
- Kopje e diplomës (ose kualifikimit akademik, përfshirë kreditë ECTS). Për kandidatët që kanë diplomuar jashtë vendit, kërkohet edhe vendimi i nostrifikimit nga MASHT-i.
- Dëshmi e përvojës profesionale, si kontrata pune apo referenca (referencat duhet të përshkruajnë saktësisht detyrat profesionale, adresën e emailit dhe numrin kontaktues të punëdhënësit). Dëshmitë mund të mbështeten edhe me raportin e Trustit Pensional, deklaratë të ATK-së ose ndonjë dokumentacion tjetër përkatës.
- Curriculum Vitae (CV).
- Deklarata e përgjegjësisë profesionale.

Aplikimi me dokumentacionin përkatës dorëzohet në formë fizike në arkivin e OIRK-së, deri në funksionalizimin e platformës për aplikim elektronik (e-licenca), drejtuar Komisionit të Odës së Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në adresë: Kompleksi Rilindja, Kontejneri Nr. 3, kati i 2-të, 10000 Prishtinë.

Për më shumë informacione, shkruani në adresën elektronike: odaexhinierëve@gmail.com

SHTOJCA 1 - FORMULARI I APLIKIMIT PËR LICENCIM

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS (OIRK)

Foto 35x45 mm

Aplikim për Licencim

Fusha e inxhinierisë:

Ndërtimtari

Makineri

Elektroteknikë

A. Të dhënat identifikuese

Emri dhe Mbiemri:		Data e lindjes:	
Numri personal:		Komuna:	
Adresa:		Numri i telefonit:	
E-mail:			

B. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Kopje e letërnjoftimit ose pasaportës	<input type="checkbox"/>
2. Fotografji me dimensione 35x45 mm	<input type="checkbox"/>
3. Kopje e diplomës (ose kualifikimit akademik, përfshirë kreditë ECTS)	<input type="checkbox"/>
4. Kopje e diplomës dhe vendimi i nostrifikimit nga MASHT-i për të diplomuarit jashtë vendit, përfshirë kreditë ECTS	<input type="checkbox"/>
5. Dëshmia e përvojës së punës në profesion	<input type="checkbox"/>
6. Curriculum Vitae (CV)	<input type="checkbox"/>
7. Deklarata e përgjegjësisë profesionale	<input type="checkbox"/>

Me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, deklaroj se të gjitha informacionet, dëshmitë dhe dokumentet e bashkëngjitura këtij aplikacioni, janë të sakta dhe të plota. Jam i vetëdijshëm se mund t'i nënshtrohem çfarëdo hetimi në rast të dhënies së informacioneve të pavërteta. Po ashtu, deklaroj se i kam lexuar, kuptuar dhe pranuar të gjitha kushtet dhe kriteret që janë paraqitur në aplikimin për licencim.

Nënshkrimi _____

Datë _____

Vërejtje: Aplikimet e paplota nuk do të merren në shqyrtim

I gjithë dokumentacioni dorëzohet në kopje fizike në arkivin e OIRK-së.

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OIRK)

LISTË E PËRVOJËS SË PUNËS NË PROFESION

Përvoja profesionale e punës duke filluar nga punësimi i fundit (shto nëse është e nevojshme):

Data		Emri i punëdhënësit	Titulli / Pozita e punës	Përshkrim i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi
Nga (muaji / viti)	Deri (muaji / viti)			

Totali i përvojës pas diplomimit: _____ vite dhe _____ muaj				

Emri, mbiemri _____ Nënshkrimi _____

Vendi: _____ Datë: _____

Kësaj liste duhet t'i bashkëngjiten **dëshmitë e përvojës së punës**: kontrata pune apo referenca (referencat duhet të përshkruajnë saktësisht detyrat profesionale, adresën e emailit dhe numrin kontaktues të punëdhënësit). Dëshmitë mund të mbështeten edhe me raportin e Trustit Pensionsal, deklaratë të ATK-së ose ndonjë dokumentacion tjetër përkatës.

Deklaroj me përgjegjësi se të gjitha të dhënat e paraqitura në këtë dokument janë të sakta dhe të vërteta.

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OIRK)

DEKLARATA E PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

Unë _____, me numër personal _____, banues në _____ (qyteti) _____, deklaroj me përgjegjësi se zotëroj njohuri për ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Kosovës që lidhen me fushën e ndërtimit, dhe do t'i zbatoj detyrimet sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore të Odës.

Do të përkushtohem për të kryer detyrat profesionale në fushën e arkitekturës dhe inxhinierisë, duke kontribuar në ruajtjen e shëndetit, sigurisë publike dhe mbrojtjen e mjedisit. Jam i vetëdijshëm për obligimin tim për të ndjekur edukimin e vazhdueshëm profesional si inxhinier i/e licencuar.

Puna dhe sjellja ime në lidhje me komunitetin, interesin publik dhe me bashkëpunëtorët do të udhëhiqet me përgjegjësi profesionale dhe etike.

Emri, mbiemri _____

Nënshkrimi _____

Vendi: _____

Datë: ____ / ____ / ____